**ADEM ZAPLLUZHA**

# PËRBALLË HIJES SË MOLLËS

Redaktor:
Shabaze Vishaj – Grajçevci, poete

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Vesel Xhaferi - Çeliku

**ADEM ZAPLLUZHA**

# PËRBALLË HIJES SË MOLLËS

"TREND"
2016

# VARGJE KUPTIMPLOTA DHE MBRESËLËNËSE

Shahbaze Vishaj - Grajçevc, poete

**“Përballë hijes së mollës”** Adem Zaplluzha, Shtëpia Botuese “Trend”, Prishtinë, 2016.

Dekada e dekada emri i Adem Zaplluzhës është i pranishëm në periodikun letrar. Vargje të shumta që u ofron lexuesve me tema e motive të ndryshme s’ka se si ata të mos i bëjë për vete, pavarësisht shtresave që u takojnë. Se vërtetë ky poet është shumë i pranishëm në letrat shqipe dëshmojnë veprat e shumta letrare, numri i të cilave tashmë ka arritur në 130, i cili titullohet **“Përballë hijes së mollës”,** ku janë sistemuar 53 poezi. Nga viti 2000 e deri më tani 2015 autori i ka shkruar 175.000 vargje, gjithsej 9.400 poezi, pra kjo flet qartë se ky autor është shumë frytdhënës në krijimin e poezive. Poezitë e këtij vëllimi janë sistemuar në tri cikle të cilat brenda vetës përbëjnë mozaik mendimesh e ndjenjash të autorit, (pikëpamje poetike), duke mos u munguar as ato filozofike. Autori Zaplluzha me përkushtim të veçantë vështron realitetin jetësor të popullit, në kohë dhe rrethana të ndryshme, e që është nxitje për t’i shprehur ato në vargje duke ia bërë me dije lexuesit mospajtimin e tij me fatin e gjendjen e mjerueshme të popullit. Edhe cikli i parë

i këtij vëllimi **“Kur i dëgjuam të trokiturat”** përbëhet nga poezi që shprehin dhembjen, gjendjen e rendë ekzistenciale të shtresës së varfër të popullit të cilët nuk mund të gjejnë derë të hapur për një të nesërme më të mirë, kur atyre sot u mungon edhe kafshata e bukës. Pra gjendje kjo që duhet të trokas në ndërgjegjen e atyre që janë në krye të vendit e që janë përgjegjësit kryesorë për situatën e këtillë. Ky cikël nis me poezinë **“Bijtë më të denjë të Kosovës”,** e cila ka 20 strofë (një lloj poeme), vargjet e së cilës tingëllojnë dhembshëm në mendje e zemër të çdo lexuesi. Kështu godasin edhe vargjet:

**“S’ka mbetur më njeri të na trokas nëpër dyer të mbyllura**
**po largohen edhe lejlekët e fundit**
**dënesin si kalama**
**drynat prej dylli kush po i mbyll me leckat e vuajtjes**
**veshtë e ofshamave prej gjëme**
**oiii të mjerët na…”**

Pra është kjo tablo reale e popullit që ka mbet nën mëshirën e atyre të pamëshirë që s’qajnë kokën për shtëpitë e boshatisura, për dënesjen e skamjen e popullit të tij. Se mjerimi e ka gojën e madhe dhe të përpinë në çdo çast jete, është dëshmia më e fuqishme kur mijëra qytetarë të Kosovës nga fshatra e qytete të saj nisen për në stacionin e dhembjes

duke kërkuar hapërim me shpresën se rruga për në vendet e Evropës për ta është një dritë jeshile për jetën. Ndërsa ana tjetër e braktisjes së vendit është shqetësim parësor i poetit i cili me nota mjaft prekëse poetizon:

"**Bijtë më të denjë të Kosovës ofshajnë nën dhe**
**kujt po ia lini atdheun**
**s'po mbetet kush në këto troje**
**që të mbjell zambakë mbi varre**
**që t'ia mbyll një ditë sytë e përlotur të kësaj toke…" (fq 11).**

Me tej në këtë cikël autori flet për të sotmen jetime se në flakën e përditshmërisë po digjen faturat e një kohe tjetër; për syrgjynosjen e suflerit në teatrin e qytetit; për lehjen e fundit të qenit në stele, të cilën e kishte ndërprerë zëri shurdhues i plumbit; për trenin e çmendur në stacionin e të cilit nusen gjatë lindjes e kishin mbuluar me gazeta e foshnjën e bekuan me pikëllim, te poezia **" Po kush nuk derdhi lot atë natë".**

Cikli i dytë – **"Përballë hijes së mollës"** ngërthen në vete vargje të spikatura, ku lexuesi do të njihet me gjithë atë që na rrethon, e përjeton në periudha të ndryshme kohore e që të rrëqethin mishtë e trupit ato përjetime.
Kështu flasin vargjet në vijim:

"**Mbi qepenat e shekullit të kaluar**
**buzëqeshin afishet e të gjitha llojeve**
**pasqyrat e modifikuara**
**premtojnë punësim marramendës…** për të vazhduar më tej me vargjet me të cilat mbyllet poezia si:

"**Edhe nëpër muret e mëhallëve**
**askush s'guxon me i lënduar afishet**
**po qe se e zënë duke fshirë pluhurin**
**shtatë ditë e net lajnë lesh në kurrizin e tij",** te poezia **"I mbulonte të gjitha fasadat e mureve".**

Ndërkaq vargjet e mëposhtme:

"**Siç e vodhën zjarrin e shenjtë**
**dhe hirin prej nesh**
**po ashtu na vodhën edhe kryqin**
**si dhe ritet tona pagane**
**vodhën çdo gjë që patën nevojë…"** e cytin autorin që ai të shpalos te lexuesi gjërat tona të çmueshme e të lashta që na i morën (vodhën) të tjerët, kur kishin nevojë, edhe pse denbabaden ishin tonat. Se trishtimi nuk i përket kësaj gjenerate dhe asaj të së nesërmes e paraqesin vargjet si më poshtë:

**"Janë fëmijët e yjeve që fluturojnë nëpër qiej**
**të tillët s'ndalen në asnjë liman**
**ata në çdo kohë i tejkalojnë kufijtë e mundësisë,** te poezia **"Tjetër pasnesër"**, ku sipas autorit ecja e

tyre e tejkalon shpejtësinë e dritës dhe këta nuk i mbyllin sytë para së vërtetës.
Cikli i tretë **"Më dukej si flutura e verbët",** ngërthen në vete 27 poezi.

"**E pashë se si përdridhej**
**në flakë çatinë e shtëpisë sime**
**nën të cilën për herë të parë u zgjova**
**shtëpia ime e mbuluar me rrasa**
**më dukej si flutura e verbët**
**nuk mund të fluturonte askund…"**

Sa e rëndësishme është shtëpia e lindjes për njeriun, kur dihet se aty ka bërë vajin e parë, belbëzimet, lojërat fëmijërore etj., flasin vargjet e sipërpërmendura, të cilat autorin e rikthejnë në të kaluarën e largët (plot jetë), por pamja e sotme e asaj shtëpie ngjanë me fluturën e verbër që nuk mund të fluturojë askund. Ky fakt është një pasqyrim i shumë shtëpive të tilla në Kosovë që rrisin edhe më dhembje e pikëllim në popull. Dhe fare në fund poezia me titull: **"Të mos digjet nga heshtja jote"** e këtij cikli, me të cilën mbyllet edhe vëllimi, janë lirikat më të veçanta të kësaj vepre letrare, ku autori me mjeshtëri thurë vargje për ndjenjën më të pastër në botë (më të pastër të njeriut), për dashurinë. Ndjenjë kjo e cila duhet të ruhet dhe në asnjë mënyrë të lëndohet. Si shumë krijues të tjerë që i kanë kënduar dashurisë, asaj më

hyjnores në jetë, edhe A. Zaplluzha ka përkushtimin e tij për mbretëreshën e zemrës siç i drejtohet:

**“Prekma sonte ballin e rrudhosur**
**aq shumë po më dhemb koka**
**sa që po më bien thinjat e kresë** … (pra kërkon përkëdheljen e së dashurës që t’i lehtësohen dhimbjet e kokës). Më tej vazhdon poeti:

**“Prekmi plagët të lutem**
**jo ato të plumbave**
**që u ngjajnë atyre të Gjergjit**
**por ato plagë që u krijuan prej heshtjes dhe fjalëve memece** …” (pra vargje këto që tronditin shpirtin e dashuruar të poetit, e që na rikujtojnë se në dashuri edhe heshtja hap plagë zemre. Dhe se përgjërimi i së cilit prej nesh para dashurisë duhet të kuptohet drejt siç flasin edhe vargjet në vijimësi:

**“Shkel me këmbët e tua të buta**
**mbi lëkurën time, kjo lëkurë e zeshkët**
**u ngjan letrave të dikurshme të dashurisë**
**të përgjëroj preke butësisht hartën e shpirtit tim**
**të mos digjet nga heshtja jote…”**

Siç shihet nga 27 strofat e kësaj poezie (poeme) dashuria është shtylla qenësore e jetës e cila në përballje me batica e zbatica të ndryshme e të shumta, ndjenja për te dhe mendimi i drejtë na bëjnë të fuqishëm dhe na mbushin me shpresë për

një të ardhme të ndritur. Ndaj edhe lodhjen, varfërinë, padrejtësinë, dimrat e egër e shumë vështirësi tjera në jetë mund të përballohen më lehtë kur mbi të gjitha këto triumfon dashuria. Prandaj me të drejtë thotë poeti:

**"Ky dimër ishte tepër i gjatë**
**po mos të ishe ti e dashura – grua,**
**mund të më ngrihej gjaku, pa ty**
**ti ndeze zjarrin e pa ndezur në mua**
**më bëre t'i harroj dimrat e acartë dhe stinët me shtrëngatë**
**gjithmonë në sytë e tu ishte pranverë …".**

Urojmë që të gjitha stinët e autorit të kenë pamjen e pranverës! Ai të ketë shëndet dhe të na dhurojë ende vargje të ngrohta jete!

# *Kur i dëgjuam të trokiturat*

## *Cikli i parë*

## BIJTË MË TË DENJË TË KOSOVËS

Do i zgjas duart
Përtej asaj ëndrre të pa ëndërruar
Të cilën kurrë nuk e pashë

Dashuria nuk është gur i murrmë
Që mund të bartet në shpirt
Por një flutur tejet delikate

Fëmijët po na ikin
Po e lënë atdheun në duar të askujt
Patëm edhe kohëra më të liga
Por nuk pat forcë
Që mund të na shkulte shpirtin
Dhe rrënjët tona

2.

Mbase po ikin
Për një krodhe buke të mykur
Që ofrojnë nëpër kampet e mjerimit
Kurse fushat tona
Dhe nuset
Po i lëmë të shkreta
E po shndërrohen në djerrinë

Kah po fluturojnë
Lejlekët e verbër të atdheut tim
Në cilin stacion të dhembjes
Do të ndalen
Ta shuajnë etjen e ndezur
Dhe mallin e pashuar për atdheun
I cili plandoset nëpër këtë lëndinë

3.

Oiii për ku janë nisur lejlekët
Po e kapërcejnë edhe këtë udhë
Po i lënë varret e përlotura
Gjëmën e të cilëve ndjejnë
Thellë
I ndjejnë lotët
Në shpirtin e nakatosur
I ndjejnë edhe shirat
Tok me kalorësit e nëntokës

S'ka mbetur më njeri
Të na trokas nëpër dyert e mbyllura
Po largohen edhe lejlekët e fundit
Dënesin si kalama
Drynat prej dylli
Kush po i mbyll me leckat e vuajtjes
Veshtë e ofshamave prej gjëme
Oiii të mjerët na

4.

Mbase edhe nënat
Paskan filluar
T'i marrin udhët e dynjanë në sy

Çfarë të bëjnë të mjerat
Kush do ua mbylli sytë
Djemve të rinj
Kur shndërrohen
Në zogj të kristaltë prej qirinjve

5.

Një pemë e vjetër
Dhe e fishkur
Aq shumë qau mbrëmë
Qau si nënat me ngashërim
Ende mbi gardhin e djegur
Po dënes po ashtu një shami e zezë

Edhe pemët nëpër kopshtet
E mbetura në duar të askujt
Filluan sërish të qajnë
Me lot pemësh
Gjethet e venitura
Po çelin disa lloje lulesh
Prej pikëllimeve të verdha

6.

Si shpirtrat e fantazmave
Po sillen vërdallë
Lagjet e tëra të boshatisura
Çatitë kanë mbetur jetim
Pa asnjë zot shtëpie

Nën cilin oxhak të braktisur
Aq dhembshëm po kuisin pragjet
Një njeri i moshuar
U paska mbetur peng pragjeve
Dhe dënes si lisi i thyer
Për të cilin
E paskan lidhur
Të vetmin qen të mbetur të fshatit

7.

Hej njerëz
Më duket se kot luftuan
Djemtë e këtij trualli krenar
Si stiva drurësh
I kemi palosur varret

Bijtë më të denjë të Kosovës
Ofshajnë nën dhe
Kujt po ja lini atdheun
S'po mbetet kush në këto troje
Që të mbjellë zambakë mbi varre
Për të ja mbyllë një ditë
Sytë e përlotur të kësaj toke

8.

Këto ikje biblike
Janë barazi me çmendurinë
I keni ngarkuar foshnjat
Nëpër djepa
Dhe ikni si fajtorë maleve

Prej kujt ky largim
Rrini këtu
Nuk mund të ikni
Në këtë mënyrë nga ky truall
As nga vetvetja
Rrini këtu
Oiii për ku jeni nisur

9.

Mbrëmë si kalama qante sterra
Lotët trokitnin në ëndrrën time
Një korb i zi nate
Mu afrua
Si makthi i sëmurë mu afrua
Dhe më zgërdheshej në fytyrë

Dikur vonë
Nuk pati durim e më tha
Unë s'pata forcë me ju përzënë
Por ju tani
Jeni duke e ndjekur vetveten

Në çdo luftë keni fituar
Pushkën e patët zanat
Por vetëm në sofrën e shtruar
Me fjalë
I humbët
Dhe do t'i humbni
Të gjitha betejat e fituara

Oii të mjerët na

Prishtinë, 17 shkurt 2015

## SA HERË JA PREKI GJETHET

E gjatë ishte ecja ime
Kudo nëpër rrugë fatura të papaguara
Sonte më duhet
Një ecje tjetër
Tejet delikate prej kristali

Kush i preu mbrëmë plepat
Kanjushat paskan ikur
Shtat bjeshkë larg atdheut tim
Një stërqok i qullur
Vajtonte mbi sinorët e fshatit

Ju thashë se e gjatë ishte
Kjo rrugë e mundimshme
E gjatë derri në ferr
Askund parajsë në këtë botë
Sa shumë gënjyen sivjet profetët

Tani më askujt nuk i besoj
Në flakën e përditshmërisë po digjen
Faturat e një tjetër kohe
E sotmja ka mbetur jetim
Nuk paska rrëndësi për askënd më

Nuk di përse kështu kaq shumë
Shqetësohet druri
Sa herë që ja preki gjethet
Një erë e fortë drithëron si furtuna
Nën rrënjët e këputura të kujtimeve
Derdhen me furi lumenjtë e fëmijërisë

## KUR I DËGJUAM TË TROKITURAT

Nëpër  lagjet e evgjitëve
Për çdo mëngjes era i lanë rropullitë
Një qukapik pa ndërprerë
I çukit drurët e njomë te plepishtat

Nëpër tryezat e drunjta
Unë për çdo ditë mbledh kafshatat
Mbledh për zogjtë që fluturojnë
Vetëm të dielave deri te kambana

Mbrëmë ishte një tjetër lloj nate
Nga sytë e së cilës vezullonin
Qirinjtë e të gjitha ngjyrave
Vetëm e verdha mungonte nëpër shandanë

Ishte vonë tepër vonë për të ikur
Kur i dëgjuam të trokiturat
Lehjen e fundit të qenit në stele
E ndërpreu zëri shurdhues i plumbit

Më pastaj vetëm heshtja e frikshme
Llamburiti nëpër rrugët e golgotës
Dyert më as nuk hapeshin
E as nuk mbylleshin më me dry të verdhë

## SËRISH ZËRI I SPIKERIT

Tani është koha për të gjitha llogaritë
Një nga një do i numërojmë
Mëkatet e njerëzve dhe të luleve
Pasi që pushuan krismat
Dikush këlthiti si sorra e manaferrave

Dhe sërish një klithmë njeriu
Pas shpinës së erës
Ngufatej zëzëllima e një blete
Mes hojeve një lojë e trishtë e minjve
Macet veç kishin filluar me mjaullimat

Nuk pushonin as pemët
Shtërzimet e rrënjëve s'kishin të ndalur
Zëri i ngjirur i spikerit
Lajmëronte ardhjen e shirave
Kurse nga degët e lulëzuara të luledielli t
Nuk mund të vilet asnjë grusht mjegull

Nuk më kujtohet athua vallë ishte mëngjesi
Ose kushte mbërri muzgu i mbrëmjes
Sërish zëri i spikerit
Shkelte nëpër shqisat e ndijimit
Mbrëmë nga teatri i qytetit
E kishin syrgjynosë suflerin

## PO KUSH NUK DERDHI LOT ATË NATË

Kur të zbresin orët e maleve
Ne të gjithë do t'i shalojmë
Kuajt e bardhë të ëndrrave tona
Ose kuajt do të na vënë mëgojëzat
Mbase është koha e ndryshimeve të mëdha

Sido që të jetë do i dëgjojmë
Këlthitjet apokaliptike të shirave
Mbrëmjet do të jenë të gjata
Do të jenë më të gjata
Se mëngjeset e trishtuara të trenave

Më kujtohet kur te stacioni i rrënuar
Një i moshuar e ndali orën
Sonte e ka radhën vetëm treni i çmendur
Tha duke dënesur me lot në sy
Edhe traversave ua pashë lotët

Po kush nuk derdhi lot atë natë
Në një qoshe të stacionit të trenit
Një nuse lindi një kërthi
Nusen e mbuluan me copëra të gazetave
Kurse foshnjën e bekuan me pikëllim

## KËTU DY OSE MË SHUMË HERË

Tashmë çdo tregim kemi mbyllur në arkë
Vetëm loja e pantomimës
Ajo lëvizje e lashtë e sekreteve të njeriut
Ka mbetur pezull në hapësirë

Loja dhe gishtat e thyera të erës
Kush i ndërseu mbrëmë cerberët
Kur dolën si nga kutia e Pandorës
Dhe gjatë tërë kohës më ndoqën deri në Ferr

Posa arritëm te ura e Kasandrës
U takuam me shpresën e ngrirë të kujtesës
Asnjë lajm për të reshurat
Mbase shirat i kishin humbur rrugët sivjet

Edhe unë jam i humbur e i përhumbur
Ne të gjithë kemi humbur
Në këtë mjegullnajë
Ka kohë që nuk i pamë dyndjet e shirave

Këtu dy ose më shumë herë në javë
Thyhen urat mes njerëzve
As mjegullnajat nuk lëvizin këndej pari
Vetëm shirat e myktë vijnë njëherë në vjet

## PO QË SE MËSOHEMI ME HESHTJEN

Po që se mësohemi me heshtjen
Gjërat sa ora humbin kuptimin
Bëhen të ftohta
Si mermerët e kuq të Kosovës

Ngjajnë me gurët e lumenjve
Duken të latuar me shpirtin e ujit
Kurse në anën tjetër në brendinë e tyre
Jeton vrazhdësia e tejdukshme

Njeriu përherë ka mësuar
Dhe mëson nga pemët shumëvjeçar
Durimi i malit gjithmonë pikon nga gjethet
Andaj janë të gjelbër peizazhet e paanë

Nëse i lajmë sytë kur zgjohet mëngjesit
Nga shpirti i gjetheve dita pikon
Pikon një lloj eliksiri
Që i shëron të gjitha plagët e luleve

Ju thashë se nga drurët njeriu mësoi
Zejen e heshtjes dhe artin e rruajtjes së zjarrit
Ishin kohërat që mateshin me durimin
Sa që vetë njeriu u ngjizë me rrënjët

## HERË U PËRNGJANIM NJERËZVE

Zogjtë kanë mbetur pa krih
Po ashtu edhe gjethet
Janë zhveshur
Kush i kafshoi mbrëmë drurët
Një zë i ngjirur
Buron nga thellësia e nëntokës

Nuk patëm kohë të ecim vertikalisht
Me qindra vjet
U përngjanim me zvarranikët
Nuk di a ishim bijtë e gurit
Ose qenie abstrakte gatuar nga dheu
Që dukeshim si të ardhur nga galaktika

Por ne gjithsesi
Mbase ishim krijesa asnjanëse
Herë u përngjanin njerëzve
E herë drurëve të verbër halor
Sa që edhe gjethet dukeshin disi ndryshe
Nuk u përngjanin njëri – tjetrit

## SI NJË QUKAPIK I SHTHURUR

Me gjymtyrë të këputur
E sy të rraskapitur
Rrjedha e dështuar e lumit
I përngjanë mortit
Dallgët derdheshin në dhembjen e kujtesës

Era me një këmishë të leckosur
Parakalonte bashkë me procesionin
Asnjeri nuk e barte arkivolin
Një hije e tejdukshme
Zgërdhihej në hapësirën blu

Asnjë kalimtar s'kishte mbetur rrugëve
Një qen i vetmuar
Me një copë kocke nxjerr nga dheu
Meditonte si një kardinal i dështuar
Hija sërish zgërdhihet me hapësirën blu

Askush sonte nuk shkoi te varret
Njeri i gjallë s'ka mbjellë një pemë këtu
Vetëm era lakuriqe
Si një qukapik i shthurur
Nëpër varret anonime i lexonte epitafet

Prishtinë, 18 shkurt 2015

## NJË SHI I VAKTË PREJ DJERSE

E shtrirë mbi shtratin e ekstazës
I prekte peizazhet e yjeve
Deti i tërbuar i qiellit mëngjesor
Ledhatonte me sy përtej xhamave
Gjërat e dukshme dhe ato të padukshme

Çarçafët lëpiheshin për mishin e njomë
Lëkura e bronztë si një statuje antike
Lëshonte një aromë ndjellëse
Nga fijet e shprishjes së flokëve
Si ujëvarë buronte epshi i mëngjesit

Humba çdo kontroll të kohës
Nuk di më sa ishte ora dje e sa është sot
Si toka e shkriftë avullon djersa
Ajo përgjumet dhe me sy prej biluri
Shikon në tejdukshmëritë e çasteve

Askurrë më parë nuk kam përjetuar
Një shi të vaktë prej djerse
Shiu i ngrohtë që derdhej nga shtambat
E ngrohta të mjegullave
E mëngjesi kurrsesi të zgjohet në këto çaste

# I TRAJTON YJET E LËNDUARA TË NATËS

Ka ngjarë dhe po ngjan edhe sonte
Që duart e tua të duken si degët
Frymojnë ngjashëm me gjethet
Mëngjeseve herët i çelin sytë e përgjumura
Ashtu siç çelin lulet e para të pranverës

Kurdoherë që i prekim gishtat e kristalta
Ndjejmë se si pëlcet njomësia e lëkurës
Nga majat e thonjve të zbukuruara
Si rrëshirë lotësh
Pikojnë dhembjet e pashmangshme të ditës

Çfarë të bëjë sonte me ty
Përse dënes si shiu i hershëm i pranverës
Sa shumë lot malli buron
Nga shpirti im i nakatosur
Si të zgjohem nga kjo ëndërr e trishtë

Nga dritarja e hapur
Shikoj hapësirën e tejdukshme
Mjegullat me duart e tyre të xhamta
I trajtojnë yjet e lënduara të natës
Më duket se s’do të kthehet mëngjesi sot

## SA QË THAHEN SI GJETHET E RËRËS

Nën xhaketën e verdhë të një druri
Si pranvera mugullojnë
Dy grusht zjarr
Nuk të kallin
Po i preke të përvëlojnë

Herë kanë një dukje
Të vullkanit i cili kurrë nuk fle
E herë janë të vdekura si lulet
Asnjë muzikë mortore
Nuk mund ta zgjojë mëngjesin

Një ditë befasisht
Rrjedhë qumështi i tërë botës
Kurse ditën tjetër papritmas
Ngjanë me oazën e etur në shkretëtirë
Sa që thahen si gjethet e rërës

Atë çast kur vjen një kohë asnjanëse
Nuk është më ajo e lulëzimit
Po ama as e rënies së gjetheve
Nga degët e shpirtit
Shkunden të fishkura lulet e mallëngjimit

## TI ISHE NISUR UDHËVE PA UDHË

Sivjet po thahen pemët
Anijet me vela
Duken si të çmendura
Mbi syprinën e detit të pikëllimit
Llamburit dallga e mbetur e mëshirës

Mbrëmë dëgjova një varrtar
Me mall i recitonte psalmet e biblës
Druri i akacies
Nuk kishte çelur asnjë lule
Një bletë e përhumbur i ngjante fluturës

Sonte s'po shoh asnjë udhëtar
Vetëm yjet notojnë eterit të vetmuar
Një zbrazëti prej qiellit blu
Mbi njëqind vjet nuk është dukur
Nëpër hapësirën e vendlindjes sime

Më duket se ishte hera e fundit
Kur u pamë atë ditë
Ti ishe nisur udhëve pa udhë
Në një tjetër qiell që s'të përket ty
Dole të kërkosh yllin tënd të shuar

## DO ECI PËRTEJ MUNDËSISË SIME

Një re e dendur na rri mbi kokë
Era frynë nga të katër anët
Gratë sivjet po duken
Se janë fishkur për disa vjet më shumë

Zogjtë po e marrin arratinë
Po ikin prej vetvetes
Askund më s'do të gjejnë një çerdhe
Ku do i lëshojnë vezët e trishtimit

Më duket se në këto çaste
Çdo gjë është përgjysmuar
Pak jam si njeri
E pak më shumë nuk i përngjaj vetvetes

Dora e djathtë po më shkurtohet
Kurse e majta
Po rritet tej mase
Sa që po përngjan me fluturimet e lejlekëve

Sonte do marri rrugë
Do eci përtej mundësisë sime
E kur të mbërrij deri te pamundësia
Do kuptoj se sa më janë zvogëluar duart

Prishtinë, 19 shkurt 2015

## POHUAN SE ISHIN DYMBDHJETË PJATA

Së pari që në nismën e darkës
I fshehën letrat e dashurisë
Dita ishte e gjatë
Pastaj dolën në bejleg hajdutët
S'lanë gjë pa vjedhur
Nga xhepat e shqyera të tokës

Pas pak çasteve asnjë thikë
Nuk dukej askund
Pranë tryezës së rrumbullakët
Pohuan se ishin dymbëdhjetë pjata
Prej bakri
Mbase edhe prej argjile
Asnjëri s'kishte lugë të mirëfilltë në dorë

Një gotë e pjekur prej dheu
Deri te gjysma e saj
E duronte verën e kuqe
Kurse gjysma tjetër qante si kërthi
Dhe pa pikë loti
I buzëqeshej ikonës së varur në mur

2.

Po e mbushi dikush deri në buzë
Atë gotë prej argjile të pjekur
Me gjasë edhe njëqind vjet të tjerë
S’do të ndalen hingëllimat
E pjergullës së kuqe
S’do të ndalen
Derisa të këndojnë gjelat e së nesërmes

Për befasinë e secilit prej të ftuarve
Një shkëmb sykaltër
Duke buzëqeshur në ballë të oxhakut
Nuk kapërdiu
Asnjë kafshatë buke të lëmekur
Me shijen e kuqe të hardhisë

Me një buzëqeshje
Të kallkantë dhe ironike shtoi
Njëri prej jush
Dje dhe po ashtu edhe sot
Kafshoi gjakun virgjër të njeriut

## ME TË NJËJTËN MASKË

Orë e çast e mbante në fytyrë maskën
Dhe syzet e zeza
Një ditë dukej si kardinal
Kurse ditën tjetër
Ngjante me hajnin e maskuar të natës

Me lëkurë të lëmuar si guralecët e lumit
Pa ndërprerë pudrosej
Pudrosej
Si ato femra që nëpër banesa
Mbanin të kyçura dritat e kuqe

Sot e shohim duke ecur vertikalisht
Kurse të nesërmen
Nuk mund të gjejë njeriu
Asnjë lloj zvarraniku
Me të cilin mund ta krahasoj këtë qenie

Njëherë s'doli në rrugë
Me të njëjtën maskë
Nga shpirti i tij si rrëshira
Përherë çurgonte një lloj naftaline
Sa që kundërmon erë të rëndë i tërë qyteti

## SHIKONTE NJË PORTRET ANONIM

Disa folje të çrregulluara
Në ditarin tim
Qëndronin të varura në çengel
Me një kryeneçësi të paparë

Dita e djeshme
Me kokëfortësinë e saj
Nuk i ngjante asnjë dite paraprake
Mbi disa murale duke qeshur
Shikonte një portret anonim

Era i kishte mbuluar shpatullat
Me një veladon të bardhë
Dhe kalonte rrugicave të lagjes
Si një mbretëreshë e cila veç ka abdikuar

Asgjë më këtu nuk duket
Siç jemi mësuar të shohim
Nëpër sytë e përditshmërisë sonë
Më duket se këtu s'banon askush më

Vetëm çafkat e bardha dhe korbat e zinj
Ndalen te shelgjishtat
Ose mbi çatitë e rrënuara
Ku asnjëherë s'pushojnë krakëllimat

# *Përballë hijes së mollës*

## *Cikli i dytë*

## I MBULONTE TË GJITHA FASADAT E MUREVE

Mbi qepenat e shekullit të kaluar
Buzëqeshin afishet e të gjitha llojeve
Pasqyrat e modifikuara
Premtojnë punësim marramendës

Pllakati i madh me ngjyrë alegro
I mbulonte fasadat e mureve
Asnjë qen rrugaç nuk guxon të ndalet
Në tre këmbë pranë ndonjë shtylle elektrike

As macet e zeza të rrugicave të qytetit
Nuk guxojnë në asnjë kohë
Me ja pre rrugën e ndonjë kuvendari
Po e bëri këtë e piu e zeza

Edhe nëpër muret e mëhallëve
Askush s'guxon me i lëndua afishet
Po që se e zënë duke fshirë pluhurin
Shtatë ditë e net lajnë lesh në kurrizin e tij

Prishtinë, 20 shkurt 2015

## POR PO NDODHIN IKJET E MËDHA

Ishte thatësi e madhe
Mjegullat e përgjumura profetizonin
Një tjetër thatësi edhe më të madhe
Çfarë të bëjmë me rrënjët
Që po e shkulin vetveten

Sivjet jo që po kthehen zogjtë
Por po ndodhin ikjet e mëdha
Këto dyndje drurësh
Po i zhveshin malet nga shpirti i durimit
Po i zhveshin fjalët lakuriqe të njeriut

Edhe dimri i acartë
Me ushta prej zjarri i vrau rrënjët
Nëpër pragjet e braktisura s'shoh më mace
S'dëgjohen as lehjet monotone të qenve
Qetësia e frikshme i ka mbështjellë pemët

S'dëgjohen as gjëmat e nënave
Sa më mungojnë piskamat e rrugëve
Më mirë një vdekje se sa kjo heshtje mortore
Ju lutem mësomani artin e durimit
Si ta përballoj këtë vdekje të mermertë

## SHNDRISIN SI BILUR TË KRISTALTË

Në pasqyrën dyfytyrëshe
Diku në sfondin e saj gri
Një mal me rrape gjigande
I shtrinë duart
I shtrin
Përtej përgjumjes së mjegullave

Në korridorin e errët
Xixëllonjat prej zjarri
Lëshojnë dritë vezulluese
Shndrisin si bilurë të kristaltë
Sytë e drurëve
Zgjohen mëngjeseve herët

Në portin përballë tavernës
Një varkë e dehur dhe e thyer
Përkundet mbi dallgët e mëngjesit
Marinarët sot qenkan zgjuar
Para këndesave
Dhe ethshëm bisedojnë
Me trishtimet e pallamarëve

Një merimangë e zezë
Posa ka fillua me thurjen e rrjetit
Heshtja e mermertë
Pa asnjë domethënie
Përkund detin e përgjumur

Mëngjesi në shpirtin e molit
Buluron si kau i dërmuar
Nuk ndalen as të lehurat
E pakontrolluara të konservave

Pranë një kontejneri të ndryshkur
Dëgjohet pallja e lopëve të sëmura
Në grevë urie me vite të tëra
Protestojnë peshqit e ngordhur
Protestojnë krimbat
Nëpër tasat e përdorura

## NË OAZËN E MENDIMEVE TONA

Në damarët e udhëve të jetës
Humbin zogjtë e dynjasë
Si nëpër shkretëtirë
Kalojnë karvanët e deveve të lodhura

Në perëndim të diellit të akullt
Ngrohën vetëm meteorët me bisht
Kur mjegullat fundosën
Në ëndrrat e oazave kaktuset çelin lule

Vetëm zvarranikët e shkretëtirës
Mund ta presin mëngjesin tjetër
Ulur mbi një gurë pikëllimi
Ulur mbi një kep të lëngtë

Ne edhe ashtu përherë i zgjasim duart
Nëpër periferitë e hapësirës blu
Në oazën e mendimeve tona
Kurrë nuk fishken lulet e shpresës

## DERI NË TOKË U LËSHUAN KALLKANËT

Dorë njeriu nuk preki te kajsishtat
Për habi të gjithëve
Si qetë e patredhur buluruan
Gjethet e para të pranverës

Thonë se ishte dimri i gjatë
Deri në tokë u lëshuan kallkanët
Acari lozte lojën e tij të çmendur
Por asnjë pemë molle nuk ngriu në kopsht

Behari erdhi shumë më herët sivjet
Nëpër bahçe çelën lulet e të gjitha llojeve
Po ashtu për bukuri çelën sivjet
Edhe pemët e egra të fshatit

## AJRI I AKULLTË NGRINTE LOTIN NË SY

Deri më sot nuk kisha mundësi
Ose nuk dija
Se si të futem në botën e fshehtësisë
Çdo ditë nga pak në mua fishket
Bari i njomë i kujtesës

Kur shkunden edhe kur nuk shkunden gjethet
Era njësoj i trajton pemët
Që nga rrënjët fillon me shartimin e barit
Njomësia kurrë më herët se sivjet
Nuk mugulloi në dimër kaq bukur

Teneqet e ndryshkura që i mbulonin çatitë
Ngjanin që të sulmoheshin nga kandrat
Po ashtu edhe milingonat e kuqe
Nuk i ndalnin sulmet e përditshme
Me brisk berberi qethnin flokët e myshqeve

Dimrat ishin të gjatë dhe të bezdisshëm
Nëpër rrugicat e ngushta pështynin kallkanët
Ajri i akullt ngrinte lotin në sy
Kurse lumi i çmendur i lagjes
Dukej një det i tërë prej akulli të mermertë

## SHISHJA E PËRGJUMUR

Gjërat e vlefshme dhe ato të pavlefshme
I patëm mbyllur në një shishe
Jo për t'i fshehur nga të huajt
Por nga vetvetja

Dielli ato ditë nuk i vezullonte ujërat
Nga stërkalat lindnin lumenjtë e tërbuar
Kurse shishja e përgjumur
Prite të hapej nga dora e njeriut

Mbase priti kot me mija vite
Deti kurrë nuk e solli shishen në breg
Një pulëbardhë e vetmuar te kepi i pikëllimit
E hapi dhembjen dhe hyri në shpirtin e detit

Atë ditë vallja e meduzave nuk pushoi
Vallëzuan edhe peshqit fluturues
Një valle e vjetër e perëndisë së ujërave
Akoma vallëzonte nëpër fushat e mëllenjave

## ZOGJTË E MI

Në rrethin e imagjinuar të unazës
Flenë pyjet magjike
Dhe një zog i trishtuar
Që kurrë nuk e zë gjumi

Para të gjithëve e zgjon agimin
I zgjon edhe këndesat e përgjumur
Kurrë s'ka ngjarë
Që ta ketë ngjashmërinë e përroit
Kështu dukej zogu im i agimeve të bardha

Më kujtohen kositësit e luadheve
Kur me këngë e valle
Hynin në shpirtin e gjelbërimit
Dhe kositnin me ndjesi të pashoq
Barin e kuq të mëllenjave

Rreshtat ishin të gjatë
Si ato të lejlekëve
Patjetër i ngjanin edhe patave të egra

Një ditë dukeshin si dasmorë
Kurse ditën tjetër
Domosdo duhej të ngjanin drurëve
Zogjtë e mi
Të shkulur nga vatra

## TJETËR PASNESËR

Kësaj gjenerate
Nuk i përket trishtimi
Janë fëmijët e yjeve që flatrojnë nëpër qiej
Njerëzit e së nesërmes
Me miliona shpresa vezulluese

Të tillët s'ndalen në asnjë liman
Në çdo kohë i tejkalojnë
Kufijtë e mundësisë
Kur mbërrin në fundin e një tregimi
Mu në atë çast gjejnë fillimin e fjalës

Këta filiz nuk duken si të tjerët
Sa herë që hedhin hapin e parë
S'ngurojnë të mbërrin
Të pamundshmen
Sepse fjala nuk mundem
S'ekziston në fjalorin e tyre

Ecin dhe ia tejkalojnë shpejtësisë së dritës
I shohin gjërat shtatë pash nën dhe
S'ka ngjarë asnjëherë
Që t'i mbyllin sytë para së vërtetës
Kjo gjeneratë që u lind tjetër pasnesër

Prishtinë, 21 shkurt 2015

## I SHTRIMË PARATHËNIET E TREGIMEVE

Mbi tryezën e varfër të shpirtit
Secili prej nesh deshëm ose jo
I shtrojmë pikëllimet
Njëkohësisht edhe gëzimet tona

I shtrojmë
Jo për ta shuar urinë
Ndonjë udhëtar i vonuar
Por për ta freskuar kujtesën që lëngon

Kur na vijnë punët ngushtë
Nga kopshti i memories
I nxjerrim të gjitha tëlarat
Dhe mbi një shami të lotëve
I shtrimë parathëniet e tregimeve

Pa shkruar asnjëherë
Asnjë fjalë
Për mëkatin e pemës së shkundur
Lexojmë trishtimin në hijen e ujit

Pastaj kur papritur
Mbërrin mosha e pjekurisë
Ndalemi në kepin e dhembjes
Dhe me biblën
Ose kuranin në dorë
I mashtrojmë gjethet e zverdhura vjeshtake
Që fishken mes kandrave të jeshilta

## THASHË SE ISHTE DIMRI I ACARTË

Ishte një dimër i acartë
Si e çmendur trokite furtuna
Nga të ftohti qanin degët e nerenxës
Një njeri i mirë
Shikonte se si ngrihen pemët

Shikonte duke zhveshur pallton e zezë
Pastaj e hoqi nga shpatullat e veta
I mbuloi degët e një peme të afërt
Dhe iku pa zë
Iku duke fërshëllyer si era

Thashë se ishte dimri i acartë
Sa që ngrihej guri i stralltë
I maleve tona
Njeriu pa pallto duke i shikuar pemët
Me lot në sy
Kërkonte ndjesë drurëve të tjerë

Edhe për dy hapa të tjerë
Kishte kohë
Ecte duke shpejtuar
Patjetër i duhej të mbërrinte deri te ura
Të mbërrinte deri aty ku ndaheshin udhët
E njerëzve dhe atyre të tjerëve

## POR EC E THUAJA KËTË MIKUT

Ne për çdo ditë dhe në çdo kohë
Nëse nuk humbim asgjë
Domosdo i humbim ditët tona
Gjithmonë jemi në hulumtim e sipër
Të atyre gjërave që na zbresin nga kujtesa

Patjetër më duhet të ju them edhe këtë
Se humbjet janë
Pjesët e pandashme dhe të përditshme
Të ekzistencës tonë
Nëse nuk humbim asgjë
Ne as nuk mund të jetojmë si duhet

Këto pjesëza të vockla të jetës
Mbase na mbajnë gjallë
Në çdo kohë shohim te njëri – tjetri
Se si i humbim
Dhe na humbin gjërat
Por ec e thuaja këtë mikut
Duke e shikuar drejt në sy

## PËR TË MBËRRI ATJE KU S'KA NJERI

Shoh njerëz se si parakalojë
Të zhveshur rrugëve të kalldrëmta
Ecin dhe u ngjajnë të vdekurve
Mbi qivure prej bungu

Kalojnë mbështjell me lëkurën e erës
Fytyrat e zverdhura si kokrrat e limonit
As gjak nuk u pikon nga degët
Ngjajnë me peshqit e ujërave të ëmbla

Nëpër xhepat e tyre të shqyera
Derdhen ujërat e turbullta të botës
Më këpucë prej lëkure pa sholla
I rrahin rrugët e gjata të dynjasë

Këta njerëz që vijnë prej një zbrazëtie
Shkojnë drejt në një boshllëk tjetër
Për të mbërri atje ku s'ka njeri
Duhet kaluar një rrugë të gjatë deri te etja

## ME NJË FIJE PREJ KUJTIMEVE

Në shpirtin e një guri të kuqërremtë
Zbuluam prejardhjen e fisit tonë
Një udhë e gjatë deri te maja e gjethit
Nuk e ndali krimbin e mëndafshit

Me një fije të hollë peri prej kujtimeve
Nga një copë guri të fortë gatuam bukën
Për befasinë tonë
I mësuam dhëmbë e dhëmballë të kafshojnë

Zbulimet e mëvonshme nuk kishin rëndësi
Zjarri na mësoi si t'i krijojmë muralet
Nëpër rrasa guri i ndoqëm kaprojtë
Dhe u mësuam ta pjekim mishin e derrave

Në fillim mish i pjekur ishte buka e jonë
Filluam të mos gatuajmë më gurë
Një njeri i urtë mbi një shkëmb shpelle
Vizatoi kokën kështu në atë rreth
Zbuloi rrethin magjik të historisë

Me vija të thjeshta zbuloi magjinë e shkencës
Mbi të cilën sot lëvizë e tërë bota
Nuk di se ku do ishim sot pa atë rreth
Ku ta di njeriu i sotëm se në cilën shpellë
Njerëzit e zbuluan vetveten

## PËRBALLË BJESHKËVE SHËTISIN ORËT E LIGA

Përballë bjeshkëve të qytetit tim
Sodis imazhet e grisura
Si delet kullosin shtëpitë piktoreske
Mbuluar me rrasa të murrme
Buzë Lumëbardhit mrizojnë pemët
Fëmijët vrapojnë
Pas guralecëve të bardhë

Një ngarendje e tillë deri askund
Ka kohë
Që s'ka ngjarë në tokën tonë
Në mbretërinë e ujit të kristaltë
Gjethet marrin frymë si peshqit
Nëpër byzylykët e nuseve
Bredhin rrugëve kalamajtë

Këto pamje i përkasin atdheut tim
Me fëmijë barkcullakë
E këpucë të shqyera
Flamujt flenë nën çatitë e rrënuara
Kurse bulurimat e qeve nuk dinë të ndalen
Bërlyket edhe hëna përballë mjerimit tonë

Para pak viteve
Këtu ngjau një luftë e madhe
Kurse pas shpine
Po na zgërdheshen hienat
Në mungesë të egos sonë të mirëfilltë
Flamujt lidhen me shtatë nyje
Përballë bjeshkëve të zeza shëtisin orët e liga

## NJË KUNDËRMIM I KALBUR PREJ MISHI

Brenda nesh i zgjidhëm të gjitha nyjat
Që i lidhën të vdekurit
Me hapa gjigande kapërcyem vetveten
Kur dolëm në anën tjetër të lumit
Beteja veç kishte përfunduar

Nëpër rrugë pamë flamuj të grisur
Dhe kuaj të ngordhur
Helmeta e ushta të thyera
Grumbuj ushtarësh me nga një sy
Dhe këmbë të prerë deri në gjunjë

Pamë edhe gra me pamje anemike
Me zemër dhe shpirt të dhunuar
Nën flokët e shprishura thahej gjaku
Nga sytë e përlotur çurgonte dhembja
Pamë edhe nëna të tjerra të ikura nga mendja

Këtu edhe kazanët me fasule kundërmojnë
Një kundërmim të rëndë
Kundërmonin edhe gjethet
Si shpirtrat e zhubravitur të njerëzve
Një duhmë e kalbur prej mishi
I dhunonte shqisat e të nuhaturit të pemëve

## ASGJË TJETËR NUK I INTERESONTE

Herët në mëngjes pa gdhirë mirë
Me të kënduar të këndesit
I mbyllte të gjitha dritaret dhe portën
E pasme të shtëpisë
Deri vonë në mbrëmje ngujohej në vetvete

Asgjë tjetër nuk i interesonte
Përpos lagështisë së mureve
Dhe ëndrrave të kandrave të verdha
Kishte një pasion të verbër
Donte që nga hiri ta ndezte zjarrin

Të tillë e kishte natyrën
Të pamundurën e kërkonte në hapësirë
Netëve të tëra bredhte varreve të qytetit
Ëndërronte për ringjalljen e të vdekurve
Ëndërronte një copë ashti fosforeshentë

Dhe përfundoi duke ëndërruar
Në një shtëpi pa dyer e dritare
Vetëm mbrëmjeve të vona
Kur mbylleshin të gjitha dyert dhe dritaret
Ai njeri e hapte zemrën dhe dyert

## NUK ERDHËM PËR TA MOHUAR DERDHJEN E LUMIT

Ju thashë se sot nuk është e nesër
As e nesërmja
Nuk mundet të jetë sot
Ky gjeth i fishkur
Fare mirë e njeh fluturimin e shqiponjës

Një ditë të gjithë ne
Domosdo do të zbresim deri te hiri
Do t'i ndezim të gjitha zjarret e vdekura
Atë çast kur ngjanë kjo mrekulli
Mund t'i zëmë lindjet e yjeve me dorë

Thonë se jemi fëmijët e së nesërmes
Por ne gjithmonë ishim
Dhe do të jemi të tillë në këtë galaktikë
Sa herë që deshëm
Pa i lagur këmbët e kapërcyem ujin

Ne nuk erdhëm këtu
Për ta mohuar derdhjen e lumit
Sepse lumenjtë kurrë nuk janë tharë
Në mendjet tona
Këtu jemi për t'i zgjuar brigjet e përgjumura

## PËRBALLË HIJES SË MOLLËS

Kur ishin latinët këtu
Unë pata një tjetër lloj kryqi
Ishte aq i çuditshëm
Sa që i ngjante
Dy trekëndëshave në një rreth magjik

I tillë ishte kryqi im i cili qëndronte krenar
Përballë hijes së mollës
Që mund të prekej vetëm në mëngjes
Prekej vetëm atëherë
Kur këndonin gjelat kryengritës të lagjes

Siç e vodhën zjarrin e shenjtë
Dhe hirin prej nesh
Po ashtu na e vodhën edhe kryqin
Si dhe ritet tona pagane
Vodhën çdo gjë që patën nevojë

Një stërgjysh im i largët
Dhe i verbët
Dy here nga dyzetë mijë vjet këndoi
Po të njëjtën këngë sa që ende sot këndon
Lahuta e tij e verbët për Itakën

## KATËR HERË NGA PESË SHEKUJ

Grumbuj njerëzish
Ulur mbi stolat prej gurëve
Ku nuk depërtonte asnjë shtëllungë drite
Këndonin në errësirën e shpellës së ftohtë

Lugët dhe enët e gurta mbi sofër
Nën të një mace e egër lëpihej
Njeriu sykaltër ndriçoi shpellën
Dhe sa ora drita hyri në errësirë

Në heshtje kapërdijnë kafshatën e fundit
Që në fillim të ngrehinës lëvizin gurtë
Muret çaheshin nga kallkanët
Një stuhi e akullt i ngriu faqet e librit

Katër here nga pesë shekuj
S'po ndalen tërmetet e zbrazëtirave
Nëpër të çarat dhe lagështit e mureve
Po depërtojnë të gjitha llojet e kandrave

## UTURIMË PAS UTURIME

Mes rropullive të sëmura të erës
E fshehën thikën
Këlthitjet e egra të çafkave
Dëgjoheshin kudo nëpër skutat e qytetit

S’ndalen as krakëllimat e korbave
Po ashtu edhe lehjet e qiellit
Uturimë pas uturime
Zbresin me gjëmat e mjegullave

Nga gjoksi i hapësirës së kristaltë
Paskan ikur mjegullat
Kurse për ardhjen e shirave
Askush nuk na tha asnjë fjalë

Por ata erdhën me rrebeshe zjarresh
Qielli i nxirr kollitej nga të ftohtit
Dëgjoheshin edhe kollitjet e pemëve
Sa bën acar kurse dimri s’duket askund

## DO ULEMI PRANË PEMËVE

Shoh se brenda teje
Ende po i fsheh ëndrrat e tua të ngrira
Një ditë del prej ujit të turbullt
Kurse ditën tjetër fundosesh në vetvete

Posa takohemi rrugët nuk na ndahen
Unë eci udhës sime kurse ti vjen
Me ëndrrën tënde të ngrirë
Dhe i acaron të gjitha kujtimet

Një ditë do të ecim deri te çezma
Të pimë ujë aty ku takohen udhët tona
Do ulemi pranë pemëve
Dhe t'i njomim kujtimet me dashurinë tonë

Sërish po të them se ëndrrat tona
Për së tepërmi ngjajnë njëra me tjetrën
Ngjajnë sepse ne nuk ëndërrojmë
Por jetojmë të këndellur për një tjetër nesër

## JANË TË ASHPRA POR EDHE TË BUTA

Sa herë që jam i lirë dhe kam kohë
Fus kokën në trastën time
Dhe i marrë rrugët drejtë monopateve
Marrë rrugët për të mbërritur
Në fshatrat shqiptare

Për së tepërmi
Më pëlqejnë imazhet e shtëpive
Të rralla e të mbuluara me dhembje
Që nga larg duken
Si arinjtë polar në kolonë

Këto vendbanime të rralla
Dhe të mistershme
Sa shumë ngjajnë me njerëzit
E këtyre anëve

Janë të ashpra këto fshatra të mira
Por edhe të buta si mjegullat
Dyert e këtyre shtëpive ngjajnë me njerëzit
Po u afrove ato çilen pa trokitur

Por nuk skuqen nga varfëria hapen
Në brendinë e thellë të tyre
Njeriu përballet me burrërinë
Dhe mikpritjen e virgjër krenare

Kurdoherë mysafirët
Janë të shenjtë nëpër këto shtëpi
U ngjajnë perëndive
S'ka njeri në botë që mund t'i lëndojë
Ndjenjat e tyre fetare dhe njerëzore

## KAM NEVOJË PËR FRYMËMARRJEN E GJETHEVE

Një ditë kur zëri im i trishtë
I ngjan fëshfërimës së gjetheve
Ose shndërrohet në jehonë
Ju mos pandehni se u ngjajë drurëve
Duart e mia
Përherë ishin dhe janë prej gjaku e mishi

Një ditë kur s'do të jem më
Në mesin tuaj
Kur do u përngjajë hijeve të pemëve
Ju mos nguroni përkundni drurët
Edhe në botën tjetër
Kam nevojë për frymëmarrjen e gjetheve

Po që se zbresin nga malet
Dimrat e acarta të ditëve të mia
Ju lutem o njerëz
Më mbështillni me kujtesën e juaj
Më kuptoni kam shumë dëshirë
Të zgjohem me mëngjeset
Kam nevojë për frymëmarrjen e gjetheve

## NGJANIN TË SËMURËVE PSIKIKË

Mbi dallgët e turbullta të jetës
Shoh anije të fundosura
Dhe varka prej kashte
Se sa shumë i ngjajnë çmendurisë
I shoh edhe peshkatarët e dehur
Kah luftojnë
Me urinë e peshqve njeringrënës

Dikur si në ëndërr i takoja
Miqtë e mi të fëmijërisë së dikurshme
I takoja nëpër ledhet e kujtimeve
Kudo shkelja
Nëpër zbrazëti të sëmura
Këmbët e mia të ngathëta
Fundoseshin si anijet e plagosura

I shihja edhe fanarët kah kyçeshin
Dhe shkyçeshin
Si xixëllonjat e lënduara

Aso kohe netët ishin të gjata
U ngjanin thikave të topitura
Ngulur në gjak
Ngjanin të sëmurëve psikikë
Që epshet e tyre shtazarake
I shuanin mbi trupat e grave të vdekura

# *Më dukej si flutura e verbët*

## *Cikli i tretë*

## QË TË ARRIJMË TE PORTAT E LIRISË

Po depërtove sonte brenda
Ose jashtë hapësirës së këtyre mureve
As Ferri e as Parajsa e imagjinuar
S'mund të të shpëtojnë nga kjo shembje

Rruga është e gjatë deri të pritja
Ti depërto nëpër këto porta të mbyllura
Në daç me mbërri jetën
Domosdo të duhet ta kapërcesh vdekjen

Ka pas raste edhe më tragjike
Të kujtohet kur digjej e përflakej gjelbërimi
E shirat nuk ishin askund
Vetëm duart tona të brishte tymonin dhembje

Kurrë më nuk u këndellën pemët
Frymëmarrja e rërës me shpejtësi rëndohej
I përngjante gjethit të fishkur
Ose pantomimës së shurdhtë të furtunës

Na u deshtë dy here nga dyzetë vjet
Që të arrijmë te portat e lirisë
Në çastin vendimtar kur mbërrimë
Një furtunë e fortë na i shembi ëndrrat

## DEPËRTONIN NËPËR MURET E PIKËLLUARA

Mbi plagët e dhembjes së njeriut
Ujqërit si merimangat
Endnin trishtimin e tragjedisë
Njëqind e dyzetë nëna e pesëqind fëmijë
I panë fluturimet e plumbave

Po aq burra atë çast u plandosën
Për tokën e shkriftë të Dardanisë
Nëpër lagje heshtja mortore
Vetëm lehjet e lukunive
Depërtonin tej pikëllimeve të mureve

Një trishtim të mermertë ndjeu dhembja
Pesëqind zëra njomëzakësh
Ushtuan në shpirtin e shpuar të Drinit
As plaga më fantazmagorike
Nuk mundi t'i gjunjëzoi nënat shqiptare

Nëpër qiellin e tunxhtë u dëgjuan
Krakëllimat metalike të shpendëve gjigand
Rrezet shpresëdhënëse dolën në dritë
Dolën nga zgërbonjat e drurëve
Kurse korbat e zgjebosur sa ora u zhdukën

## MË DUKEJ SI FLUTURA E VERBËT

E pashë se si përdridhej në flakë
Çatinë e shtëpisë sime
Nën të cilën
Për herë të parë u zgjova

Ku filluan ëndrrat e mia të para
Ku për herë të parë
Ballë për ballë u takova me jetën
Atë ditë e pashë
Se si përpëlitej nën flakë drita

Shtëpia ime mbuluar me rrasa
Më dukej si flutura e verbët
Nuk mund të fluturonte askund

E hutuar tej mase
E frikshme sillej e pështillej rreth flakës
Asnjë piskamë nuk u dëgjua
Mbase edhe ajo
Është mësuar të rezistoj në heshtje

Oxhaku kryeneç si sot e atë ditë
Qëndron krenar
Dhe gjithmonë do qëndrojë pingul

Po ashtu çdo gjë u shndërrua në hi
Përpos pragut të derës që shpëtoi
Pa prekur
Ajo gjuhë gjarpër e flakës

Shtëpia ime dhe ëndrrat e mia
Do jenë përherë atje
Po në atë vend
Me oxhakun pingul
Dhe kreshtën e gjelit të metaltë

Do jetë aty
Duke biseduar me kaltërsinë e qiellit
Shtëpia ime muze prej hiri
E zjarri
Që kurrë nuk do i shuhet dhembja

## NGA KOKAT TONA TË PABINDURA

Nuk më kujtohet a ishte ai
Mbase edhe ajo
Por mbi tavolinën e pluhurosur
Vetvetiu shfletohej një libër

Nuk di a e bënte këtë dorë njeriu
Ose era e shfletonte kohën
Por faqet e pluhurosura të një libri
Si drita hapeshin mbi tavolinën e punës

Sa herë që e vendosnim në sirtarë
I dëgjonim disa zëra të lashtë
Më duket se ishin thirrjet e gjyshërve
Por ai libër nuk e duronte errësirën

Sa herë që desha ta lexoj
Në fakt
Libri më lexonte mua
Dhe mendimet e mia

Fletat e pluhurosura hapeshin
Si petalet e zambakëve
Po sa të çelura
Dhe më nuk mund të di askush
Se cila skutë e lexonte atë dhembje

Por mbrëmjeve të vona
Dhe të qeta
Kur dëgjohej vetëm zëzëllima e bletës
Dëgjoheshin edhe disa zëra anonimë

Më pëlqenin ato thirrma
Që vinin nga sirtari i vjetër
Ishin thirrjet e gjyshërve
Që donin të na e shkundnin pluhurin
Nga kokat tona të pabindura

## NUK BISEDON ME ASNJË UDHËTARË

Zogjtë nuk fluturojnë përherë
Në drejtim të atdheut
Ne s'kemi se pse të lodhemi
Për itineraret e trenave të mëngjeseve
Ose të mbrëmjeve

Fërshëllimat dhe ofshamat e vagonëve
Asnjëherë nuk pushojnë
Vetëm ndonjëherë ngjan që të ndryshoj
Koha e nisjeve dhe e ardhjeve
Këtu për çdo ditë
Protestojnë valixhet e zbrazëta

Harrova t'ju them
Asnjëherë mos e matni kohën
Me orën e përgjumur të stacionit
Këtu edhe akrepat e orës së murit
Dinë të vonohen më shumë se trenat

Ndodh që ndonjë natë kur dehet makinisti
Treni nuk ndalet në stacion
Por ikën diku nëpër luadhe
Dhe në shenjë proteste
Nuk bisedon me asnjë udhëtar

## KUR NUK KANË SE KU TË BANOJNË

Gjërat në qytetin tim
Duken të çuditshme
Janë si heshtja
Nëpër rrugë ecin pa identitet
Si qukapikët çukitin nëpër drurët e alesë

Parakalojnë pa zë si në procesionin mortor
Kanë një ngjyrë të kaltër
Herë u ngjajnë zogjve
E herë identifikohen me fluturat
Që vdesin vetëm të dielave
Kur loton kambana në heshtje

Dita e hënë ose e mërkurë
Nuk ekzistojnë
Në itinerarin e mendimeve të tyre
Udhëtojnë të vetmuar duke u fshehur
Nëpër xhepat e mjegullave klandestinë

Kur nuk kanë se ku të banojnë
Prehjen e kërkojnë nëpër degët e pemëve
Ngjajnë me kukuvajkat e natës
Dhe mbrëmjeve të vona
Duken si zogjtë e vdekur të fushave

## DIKU NË HORIZONT

I zgjasim duart prej bore
Prekim shtëpitë që po na largohen
Me gishtat tona të gjatë
Prekim dendësinë e ajrit
Dhe thellësitë e deteve

Mjegullat e bronzta si tunxhi
Rëndohen mbi qepallat e thinjura
Më duket se na ka mbetur shumë pak kohë
Ajo më nuk troket në dritaret tona

Më thanë se i ka grisur biletat e udhëtimit
Dhe paska vendosur
Me pritë fillimin e vjeshtës
Ose fundin e saj
Diku nën shelgun e pikëlluar

Sërish i zgjasim duart në drejtim
Të shtëpive që largohen
I prekim lulet para se të fishken

Nëpër mendjet tona
Fëshfërin me qindra mendime
Hijet e mbrëmjes largohen me çatitë
Diku në horizont
Si mjegullat lëvizin imazhet e puthjeve

## GJITHNJË DIMËR NË QYTETIN TIM

Gjithnjë dimër në shtëpinë tonë
Nëpër rrugë
Era loz me gazetat e shqyera
Pranvera ishte dikur këtu
Por sot i ngjanë
Një imazhi të largët prej dimri

I tërë fshati po i përngjan dëborës
Vera as vjeshta
Kurrë nuk ishin më këtu
Edhe në shpirtrat e njerëzve
I shoh puthjet e ngrira të mëngjeseve

Po ju them
Gjithnjë dimër në këtë qytet
Me këmishën time të fëmijërisë
Po i mbuloj pemët të mos mërdhinë
Edhe nëpër damarë njerëzish
Buron gjaku i ftohtë e i kristaltë prej shtreze

Kudo dimër rrugëve të boshatisura
Nëpër skutat e mëhallëve
Parakalojnë palltot e zeza
Në mendjet tona zihet fasulja
Gjithnjë dimri troket në dritare
Gjithnjë dimër në fshatin tonë

## GJELBËRIMI TË DUKET I ERRËT

Kur të pengon vetvetja
Del nga lëkura e jote dhe i shtrinë duart
I shtrinë deri te ëndrrat e pemëve

Çdo lëvizje të duket si një zhgjëndërr
I zgurdullon sytë shikon sterrën
Shikon derisa të zmadhohen bebëzat

E hap gojën dhe dritaret
Përtej xhamave të ngjyrosura me kaltër
Gjelbërimi të duket i errët

Ti përbrenda dhomës së shurdhët
Ose brenda hijes tënde vrapon
Vrapon si kaprolli deri në asgjësim

Kur shikon me vëmendje pas shpine
S'mund të gjendesh se ku je
Por ama as nuk di se për ku po vrapon

Disa hije të shthurura para dhe pas teje
Ngarendin diku të hutuara
Kurse ty sërish të pengon vetvetja

## FTESA

Kush e di se sa vetë
Sonte shkelin nëpër brendinë time
Vetëm hapat e bronztë tringëllinë
Rrugëve të kalldrëmta të qytetit

Sonte nga një dërgues anonim
Më erdhi një ftesë për ballo
Nuk di a të shkoj unë vetëm
Ose të nisem me qindra njerëz të tjerë

Domosdo më duhet të shkoj
Atje më pret një muzikë mortore
Por nuk di se si të ja bëjë
Më këto pantallona të fishkura

Nuk kam as këmishë të mirëfilltë
Më duhet ta veshi lëkurën time
Nata do të jetë e gjatë
Si merimanga e zezë do i endim fjalët

Haber s'kam se kë do ta takoj atje
Patjetër do vijnë miqtë e mi
Të veshur e pispillosur si na bankat e shkollës
Kurse mua do më mungoj akoma këmisha

## KUR I VJELIM PJERGULLAT E KUQE

Gjithmonë në trastën time
Kam nga pak shpresë
Me syrin e majtë i shikoj detet
Kurse me të djathtin
Trishtimet e bjeshkëve

Gurtë nuk më pëlqejnë aspak
Ata mi përkujtojnë varret
Sa herë që më bie rruga
Të kaloj andej pari
I dëgjoj me ankth vajet e gjyshërve

Më pëlqen ngjyra dhe shija e ujit
Ato flluska të vogla si yjet në miniaturë
Sa shumë ngjajnë netëve të vjeshtës
Dhe xixëllonjave
Kur vilen pjergullat e kuqe
Në atdheun tim të bukur

Prishtinë, 23 shkurt 2015

## TË MOS DIGJET NGA HESHTJA JOTE

Të lutem e dashur
Në këtë çast të trishtë
Prekma sonte ballin e rrudhosur
Kam kokë dhembje
Aq shumë më dhemb koka
Sa që po më bien thinjat e kresë

Afroma dorën tënde të butë
Le të lëshohet si pendël mbi trupin tim
Të bie me delikates
Ashtu siç lëshohej dikur në rini
Me tërë epshin e natyrës

Prekmi plagët të lutem
Jo ato të plumbave
Që ngjajnë atyre të Gjergjit
Por ato plagë që u krijuan
Prej heshtjes dhe fjalëve memece

**2.**

Të përgjëroj si Hyjin
Shkelë me këmbët e tua të buta
Mbi lëkurën time
Prekmi me duart e tua plagët
Po ta dije sa kam nevojë për prekjet e tua
Kurrë s'do t'i largoje gishtat

Sa shumë po i ngjan sonte
Kjo lëkurë e zeshktë
Letrave të dikurshme të dashurisë
O të përgjëroj
Preke butësisht hartën e shpirtit
Të mos digjet nga heshtja e jote

Ne jemi në fund të udhëtimit tonë
Në daç ta përjetojmë fillimin
Fillo së pari me prekjet
E lotëve të tua prej gejzeri
Pastaj do të kuptojmë
Se kësaj rruge askund nuk i gjendet fundi

3.

O më prek vetëm sonte
Pastaj le të del
Ku të dal kjo rrugë e mundimshme

Nuk kemi shumë kohë
I kemi shkundur të gjitha degët
Kanë mbetur
Vetëm prekjet e tua prej pemëve

Shiko përreth asnjëherë nata
S'ka qenë më e bukur se sonte
O të lutem e dashur më prek
Derisa zgjasin këto çaste
Ti asnjëherë mos u ndalë me prekjet e tua

Më prek edhe mbi plagën time
Çmende shpirtin
E lumit gjysmë të çmendur

Ndoshta të kujtohen pemët
Kur si të çmendur i shkundnim frytet
Ishte një pranverë e begatë atëherë

Ai shpërthim i gjelbërimit
Kurrë më nuk u përsërit
Për herë të dytë
Në fushën e mëllenjave

**4.**

Të thashë
Dhe sërish po të them
Prekma sonte lëkurën time prej bualli
Sa shumë e kanë regjur vuajtjet
Preke të lutem si dikur që e prekje

Asgjë në jetë nuk qenka si malli
Kam shumë mall
Aq shumë mall në këto çaste
Sa që po më mpihen trutë
Vetëm prekja e jote skofiare
Mund ta zgjojë njeriun në mua

Më ndje të lutem e dashura grua
Mos i ndalë të prekurat deri tjetër nesër
Kjo natë është e shkurtë
Sa ora këndesat zgjojnë mëngjesin
E me të zgjohen edhe vuajtjet tona

Prek e mos u ndalë o erë e shenjtë
Sonte jam i tëri njeri
E nesër do shohim
Se në cilën bishë shndërrohem
Prek të lutem më prek deri në amshim
Mos i ndalë të prekurat në këtë delirium

**5.**

Çdo mbrëmje e çdo menatë
Para se të zgjohem
Nën lëkurën time të zeshktë
Thellë i ndjej zukatjet e prekjeve tua

Po sa i hapi sytë
Fundosem në zbrazëtinë e një vetmie
Vetëm ti dhe gishtat e tu
Mund të më nxjerrin nga ky ankth

Sekondat janë të stërgjata
Me miliona vjet
Nuk mund t'i mbërrij
Por vetëm prekjet e tua të mishta
Mund të më zgjojnë nga kjo pandjesi

**6.**

Përse je kaq e frikësuar në këtë moment
Mos druaj
Preke lëkurën time të bronztë
Nën çarçafin me aromë karafili

Preke se nesër mund të fishket e tëra
Një kohë të gjatë
Vjeshta ka shkelur mbi gjakun tim
Tani më është pakëz vjeshtë
E pakë më shumë dimër i acartë

Nesër ndoshta kjo lëkurë e fishkur
Do shndërrohet në flutura të djegura
Po e preke ti e dashur
Sa ora poret pësojnë metamorfozë

Mos prit të lutem mos
Vëri në lëvizje duart e tua të mishta
Më prek sa të duash deri në menatë
Kurse nesër mund t'i përcjellë zogjtë e tu
Në folenë e përhershme të amshimit

**7.**

Ky dimër ishte tepër i gjatë
Po të mos ishe ti e dashur
Mua do të më ngrihej gjaku
Vetëm duart e tua të brishta
Pa i prekur dallgët kapërcyen lumin

Edhe më herët gjatë jetës
Pamë dhe përjetuam dimra të tillë
Por ti si një flutur e kaltër
I kyçe në shpirtin tim
Të gjithë kandilat e dynjasë

Besoj se të kujtohet
Kur atë ditë
E ndeze zjarrin e pa ndezur
Në sytë e mi të egër e të gështenjtë

Vet më tregove
Se si ishin shkrirë kallkanët e botës
Më bëre t'i harroj dimrat e acartë
Dhe stinët me shtrëngatë
Gjithmonë në sytë e tu ishte pranverë

Prishtinë, 24 shkurt 2014

# SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

# BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. “Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o. “Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010

32. “Zgjimi i gjëmës”,Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. “Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. “ Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. “ Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. “ Përtej teje”,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg” , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12

48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012

64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 “ Përfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013

80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91.”Krakëllimat e natës”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014

96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. ” Stina asnjanëse” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. “ Një grusht dashuri” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim” , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. . “Si trenat e verbër ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 . “Kur teshtinë era ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”- Prishtinë, 2015

111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
116”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ” , Poezi Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
123 **. “Përtej portave të mbyllura” ,** Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
124. **“Malli i etjes”** Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
125**. “Kur qajnë pemët ”** , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
126. **“Të dielave në qytetin tim** ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016

127**. “ Nëpër brigjet e kujtesës”**Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
128. “**Rrugës qante një stërqok”** , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
129 **“Kali im prej bore” ,** Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
130 **“Përballë hijes së mollës ” ,** Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016

# PËRMBAJTJA

**Kur i dëgjuam të trokiturat**
**Cikli i parë**.....13

Bijtë më të denjë të Kosovës.....15
2.....16
3.....17
4.....18
5.....19
6.....20
7.....21
8.....22
9.....23
Sa herë ja preki gjethet.....24
Kur i dëgjuam të trokiturat.....26
Sërish zëri i spikerit.....27
Po kush nuk derdhi lot atë natë.....28
Këtu ndy ose më shumë herë.....29
Po që se mësohemi me heshtjen.....30
Herë u përngjanim njerëzve.....31
Si një qukapik i shthurur.....32
Një shi i vaktë prej djerse.....33
I trajton yjet e lënduara të natës.....34
Sa që thahen si gjethet e rërës.....35
Ti ishe nisur udhëve pa udhë.....36
Do eci përtej mundësisë sime.....37
Pohuan se ishin dymbëdhjetë pjata.....38
2.....39
Me të njëjtën maskë.....40
Shikonte një portret anonim.....41

**Përballë hijes së mollës**
**Cikli i dytë**.....43

I mbulonte të gjitha fasadat e mureve.....45
Por nuk ndodhin ikjet e mëdha.....46
Shndrisin si bilur të kristaltë.....47
Në oazën e mendimeve tona.....49
Deri në tokë u lëshuan kallkanët.....50
Ajri i akullt i ngrinte lotët në sy.....51
Shishja e përgjumur.....52
Zogjtë e mi.....53
Tjetër pasnesër.....54
I shtrimë parathëniet e tregimeve.....55
Thashë se ishte dimri i acartë.....57
Por ec e thuaja këtë mikut.....58
Për të mbërri atje ku s'ka njeri.....59
Me një fije prej kujtimeve.....60
Përballë bjeshkëve shëtisin orët e liga.....61
Një kundërmim i kalbur prej mishi.....63
Asgjë tjetër nuk i interesonte.....64
Nuk erdhëm për ta mohuar derdhjen e lumit.....65
Përballë hijes së mollës.....66
katër herë nga pesë shekuj.....67
Uturimë pas uturime.....68
Do ulemi pranë pemëve.....69
Janë të ashpra por edhe të buta.....70
Kam nevojë për frymëmarrjen gjetheve.....72
Ngjanin të sëmurëve psikikë.....73

**Më dukej si flutura e verbët**
**Cikli i tretë**.....75

Që të arrimë te portat e lirisë.....77
Depërtonin nëpër muret e pikëlluara.....78
Më dukej si flutura e verbët.....79
Nga kokat tona të pabindura.....81
Nuk bisedonin me asnjë udhëtarë.....83
Kur nuk kanë se ku të banojnë.....84
Diku në horizont.....85
Gjithnjë dimër në qytetin tim.....86
Gjelbërimi të duket i errët.....87
Ftesa.....88
Kur i vjelim pjergullat e kuqe.....89
Të mos digjet nga heshtja e jonë.....90
2.....91
3.....92
4.....94
5.....95
6.....96
7.....97

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Përballë hijes së mollës / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : “Trend”, 2016. – 110 f. ; 21 cm.

Shënime për autorin : f. 98-107

**ISBN 978-9951-694-57-5**